



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:224683

Datë: 28.06.2024

Numri i dokumentit: 05876682

KPPP.nr.1690/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen përmbaremore të kreditorit “INFRAKOS” SH.A., me seli në Sheshi i Lirisë, Fushë Kosovë, kundër debitorit “Vizionledd Group” SH.P.K., me numër unik identifikues 8114194827, me adresë në rr. Rr. Jashar Salihu, nr. 8, Prizren, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbaremore P.nr.218/2023 të datës 04.10.2023 të Përmbaremit Privat Emine Sherifi - Lubeniqi, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datës 28.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit “Vizionledd Group” SH.P.K., dhe Urdhri P.nr.218/2023 i datës 04.10.2023 i Përmbaremit Privat Emine Sherifi - Lubeniqi, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbaremi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “INFRAKOS” SH.A., ka lëshuar Urdhrin Përmbaremore P.nr.218/2023 të datës 04.10.2023 me të cilin e ka lejuar përmbaremitin në bazë të dokumentit të besueshëm, Faturës Q-11-34055 të datës 31.03.2023; Faturës Q-11-34056 të datës 31.03.2023; Faturës Q-11-34057 të datës 31.03.2023; Faturës Q-11-34345 të datës 30.04.2023; Faturës Q-11-34640 të datës 31.05.2023; Faturës Q-11-34944 të datës 30.06.2023; Faturës Q-11-35157 të datës 31.07.2023; Faturës Q-11-35457 të datës 31.03.2023, me të cilin ka detyruar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri kreditorit t’ia paguaj borxhin në shumën prej 5,006.16€ me kamatë ligjore prej 8% deri në pagesën e plotë si dhe shpenzimet e procedurës së përmbaremitit përmes bllokimit të të gjitha llogarive bankare dhe regjistrohët, konfiskohët dhe shitët pasuria e debitorit si në sende të luajtshme po ashtu edhe paluajtshme të tjera në tërë masën pasurore të debitorit.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit, brenda afatit ligjor debitori ka ushtruar prapësim me të cilin ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbarimor me arsyetimin se përmbaruesi privat ka vepruar në kundërshtim me nenin 37 të LPP-së, pasi që në rastin konkret organi përmbarues ia ka dorëzuar propozimin palës kundërshtare por nuk ia ka bashkangjitur provat, përkatësisht faturat me të cilat është iniciuar kjo procedurë përmbarimore ashtu që në mungesë të provave – faturave të cekura në propozim nuk mund të deklaromi lidhur me kushtet dhe kriteret nëse të njëjtat fatura i plotësojnë kushtet e parapara me nenin 27 të LPP-së. Po ashtu ka theksuar se debitori e kundërshton detyrimin pasi që të njëjtin pjesërisht e ka përmbushur dhe kartela e kreditorit nuk është e saktë, Ka shtuar se bazuar në nenin 71 par. 1 pika 1.2. të LPP-së, për shkak se detyrimi i kreditorit është përmbushur, faturat janë pa efekt juridik andaj i ka propozuar gjykatës që të aprovojë si të bazuar prapësimin e debitorit dhe të shfuqizojë urdhërin përmbarimor.

Kreditori në përgjigje në prapësim ka kundërshtuar pretendimet e debitorit si të pabazuara dhe ka shtuar se baza e faturave rrjedhë nga Kontrata e Qirasë nr. 23/455-1 e datës 20.02.2023 e lidhur mes debitorit dhe kreditorit për shfrytëzim të pronës dhe se faturat përmbajnë të gjitha elementet e nevojshme dhe të njëjtat janë të përshtatshme për përmbarim, andaj gjykatë si ka propozuar që të refuzohet prapësimi i debitorit dhe të mbetet në fuqi urdhëri përmbarimor.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje: “LPP”) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi, për këto arsye:

Gjykata vlerëson se organi përmbarues ka lejuar përmbarimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*.

Neni 29, paragrafi 1 i LPP-së, përcakton se: *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa pika 1.3 e të njëjtit nen përcakton faturën si dokument i besueshëm sipas të cilës mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, me paragrafin 3 të të njëjtit nen parashihet se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Në anë tjetër, sipas nenit 37 të LPP-së: *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të*

dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”.

Gjykata vlerëson se Urdhri Përmbarimor P.nr.218/2023 i datës 04.10.2023 bazohet në dokumentin e besueshëm, përkatësisht Faturës Q-11-34055 të datës 31.03.2023; Faturës Q-11-34056 të datës 31.03.2023; Faturës Q-11-34057 të datës 31.03.2023; Faturës Q-11-34345 të datës 30.04.2023; Faturës Q-11-34640 të datës 31.05.2023; Faturës Q-11-34944 të datës 30.06.2023; Faturës Q-11-35157 të datës 31.07.2023; Faturës Q-11-35457 të datës 31.038.2023, në lartësi të përgjithshme prej 5,006.16€, e cila i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm siç kërkohet me nenin 29, paragrafi 3 të LPP-së, për arsye se në to janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë emërtuar mallrat me të cilat është shërbyer debitori, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi. Për më tepër, gjykata gjen se faturat mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri përmbarimor është lëshuar me rregull nga ana e kreditorit.

Po ashtu, gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri përmbarimor, i plotëson kushtet në kuptim të nenit 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që e njëjta i është bashkëngjitur propozimit për përmbarim në origjinal.

Ndërsa, lidhur me pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim në lidhje me përmbushjen e detyrimit gjykata gjeti se debitori nuk ka bashkëngjitur prova lidhur me të njëjtat pretendime andaj të njëjtat i vlerësoi si të pabazuara.

Nga sa më sipër, bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1690/23, datë 28.06.2024

Gjyqtari

Arnis Dumani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.